PLANI VJETOR I KOPSHIT "TURGUT OZAL" 2026-2027

TURGUT OZAL
INSTITUCIONET
ARSIMORE



Kopshti jopublik Turgut Ozal
Datë: 22.10.2026
Nr. Prot.: 300-021/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS

Nr 245/18 Prot

Durrës, më . 28. 09 .2026

Lënda:Shqyrtimi dhe miratimi i planit vjetor

Drejtuar: Kopshtit Turgut Ozal

Bazuar në Urdhërin nr 31 datë 28.01.2020"Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"KREU XI "Plane të institucionit arsimor,Vlerësim i brendshëm ,Raporti vjetor ,neni 53 "Synimi objektiva dhe të tjera të planit vjetor të institucionit arsimor " pika 6

Pas shqyrtimit të Planit Vjetor të Kopshtit Turgut Ozal për vitin shkollor 2026–2027, **ZVA Durrës miraton Planin Vjetor të Kopshtit** , pasi ka përmbushur kriteret e strukturës ,elementët përmbajtësor të një planifikimi dhe duke vlerësuar se objektivat, veprimtaritë janë në përputhje me nevojat dhe prioritetet e institucionit.

Institucioni Arsimor ngarkohet me zbatimin e Planit Vjetor gjatë vitit shkollor 2026–2027, monitorimin e vazhdueshëm të realizimit të objektivave dhe veprimtarive të përcaktuara në të, si dhe evidentimin e rezultateve të arritura.

Ky miratim bëhet me kushtin që institucioni të zbatojë planin sipas përmbajtjes së miratuar

DREJTOR

Amarilda THËRMIJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, DURRËS
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
KOPSHTI JOPUBLIK "TURGUT OZAL" DURRËS

PLANI VJETOR I PUNËS SË KOPSHTIT JOPUBLIK "TURGUT OZAL" DURRËS

Viti shkollor 2026-2027

Drejtori Didaktik

Mynevere TERPO

Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës

Amarilda THËRMIJA

GUSHT 2026

I. Baza ligjore
II. Procedura e hartimit të planit
III. Analiza e gjendjes
IV. Synimi i kopshtit
V. Objektivat e kopshtit
VI. Tabela e veprimtarive për objektivat përkatëse
VII. Aktivitetet në kopsht
VIII. Kontributet
IX. Grupi i punës

I. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS:

1. Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
3. Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
4. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në masën që zbatohet për institucionin publik.
5. Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përfshirë ndryshimet e miratuara me Urdhrin nr. 300, datë 19.06.2024 dhe Urdhrin nr. 420, datë 27.08.2025.
6. Udhëzimi nr. 23, datë 01.09.2025, për përcaktimin e rregullave dhe masave për ndalimin e përdorimit të telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura në institucionet arsimore parauniversitare.
7. Udhëzimi i përbashkët nr. 20, datë 13.08.2025, për miratimin e rregullores për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare.
8. Urdhri i përbashkët nr. 110, datë 21.04.2026, për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2026–2027 në sistemin arsimor parauniversitar.
9. Kurrikula dhe programet e arsimit parashkollor, standardet e zhvillimit e të nxënit dhe Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit.
10. Kodi i Punës, legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen nga zjarri, emergjencat civile, higjienën, ushqimin, arkivat dhe aktet e tjera në fuqi.

Akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë

II. PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT

Bazuar në Rregulloren për IAP neni 51 për Planin Vjetor të institucionit arsimor, grupi i punës është i përbërë nga mësues dhe prindër për të hartuar planin vjetor për vitin shkollor 2026-2027

Për hartimin e Planit Vjetor të Punës për vitin shkollor 2026 - 2027, të kopshtit jopublik "Turgut Ozal" Durrës, u sigurua paraprakisht formimi i grupit qëndror të punës, si dhe nëngrupet që mblodhën dhe realizuan përpunimin e të dhënave, si dhe rezultatet e këtyre të dhënave teknike. Referimi e krahasimi u bë në bazë të dokumentacionit zyrtar përkatës i cili paraqitet në institucionet arsimore drejtuese qëndrore.

Në përfundim u formulua synimi në përputhje me Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2020-2026, objektivat përkatëse dhe veprimtaritë, së bashku me vëzhgimet për ndjekjen e realizimit të tyre.

- *Modernizimi i infrastukturës së kopshtit në funksion të mirëqënies së fëmijëve dhe procesit mësimor.*
- *Arritja e rezultateve sa më të larta në olimpiadat e parashkollorit.*
- *Konsolidimi i mëtejshëm i marëdhënieve kopsht-prindër-komunitet*

III. ANALIZA E GJENDJES

a. Ndjekja e kopshtit:

- *Numri i fëmijëve të kopshtit tonë për vitin shkollor 2025 – 2026 ishte 160, nga të cilët 64 ishin femra.*
- *Kopshti ynë këtë vit mësimor kishte në përbërjen e tij fëmijë të shpërndarë si më poshtë :*

- *Grupi i parë 39 fëmijë gjithsej nga të cilët 15 vajza*
- *Grupi i dytë 42 fëmijë gjithsej nga të cilët 29 vajza*
- *Grupi i tretë 79 fëmijë gjithsej nga të cilët 40 vajza*

Anët e forta të kopshtit:

1. *Kopshti gjatë vitit të kaluar 2025 - 2026 realizoi objektivat themelore të parashikuara.*

2. *Mësuesit punuan intensivisht në zbatimin e teknikave dhe strategjive të reja mësimore dhe përdorimin e metodave të përshtatshme të mësimdhënies.*
3. *Mësueset u trajnuan dhe u specializuan në risitë më të reja të mësimdhënies nga agjenci të huaja dhe shqiptare.*
4. *U zhvilluan veprimtari artistike, kulturore e sportive brenda kopshtit në kuadrin e festës së Shpalljes së Pavarësisë, të Vitit të Ri, të 7-8 Marsit, Ditës së Tokës, Festa e Lamtumirës për grupet të treta si dhe festa e 1 Qershorit gjithashtu u zhvillua dhe konkursi "Olimpiada e Parashkollorit" për fëmijët e grupit të tretë.*
5. *U zhvilluan veprimtari dhe aktivitete jashtë kopshtit, si vizita në qendrat e punës së prindërve, vizita në spitale dhe klinika dentare, ditë sportive në Pezë, shëtitje në Kodrat e Liqenit, vizitë në Muzeun Historik Kombëtar dhe atë të Shkencave të Natyrës,vizita tek ferma"Albanët", shëtitje në parkun Sektor Rinia etj.*
6. *Të gjitha këto arritje e kanë bazën tek puna e përgjegjshme dhe e motivuar e stafit pedagogjik, i cili është i kualifikuar dhe me përvojë, si dhe menaxhimi i mirë i kopshtit dhe bashkëpunimi i frytshëm me prindërit.*

Nevoja për përmirësim të kopshtit:

Krahas arritjeve ka vend për përmirësim të mëtejshëm dhe punë konkrete në këto drejtime:

1. *Shoqërimin e fëmijëve të grupit të parë dhe të dytë për tek menca. Mësueset duhet të jenë shumë të kujdesshme dhe t'u japin ndihmën maksimale fëmijëve gjatë kësaj kohe.*
2. *Pajisja me një ambient më të madh për lojërat me rërë dhe ujë.*

b. Arritje lëndore:

- *Në kopshtin tonë 78 % e fëmijëve që mbarojnë ciklin parashkollor lexojnë dhe njohin numrat shumë mirë.*
- *Janë organizuar çdo muaj "Orë të hapura", duke patur fëmijën në qendër të mësimit.*
- *Çdo orë mësimore realizohet mbi bazën e arritjeve të kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës.*

- *Përmbushja e programit të çdo grupi dhe lënde të ndërthurura edhe me realizimin e projekteve kurrikulare, konform çdo udhëzimi të ardhur nga MA dhe ZVA Durrës.*

c. Mësuesja:

- *Për vitin shkollor 2025-2026 numri i personelit të kopshtit ka qenë 17, prej të cilëve 3 drejtues.*

  Në gusht 2026 mësuesit janë trajnuar dhe do të vazhdojnë të trajnohen përgjatë vitit shkollor 2026-2027 me trajnues vendas dhe të huaj.
- *Nuk ka patur asnjë orë mësimore të munguar nga mësuesi pa arsye kundrejt të gjitha orëve mësimore në vitin e sapokaluar.*

KONTROLLI I BRENDSHËM I KOPSHTIT

Plan i kontrollit të drejtorisë së kopshtit.

Në përmbajtje të tij do të jenë:

1. *Orë kontrolli dhe vëzhgime, që lidhen me synimet dhe objektivat e kopshtit.*
2. *Orë kontrolli dokumentacioni dhe regjimi ditor:*
   - *Disiplina në punë e mësuesve;*
   - *Ditare dhe plane mësimore dhe edukative;*
   - *Regjistra dhe dokumente të tjera;*
   - *Higjienë dhe pastërti;*
   - *Asistenca shëndetësore;*
   - *Psikologu në kopsht;*
   - *Rregulli brenda në kopsht;*
   - *Aktivitete në ambient të hapur;*
   - *Pajisja me bazë materiale e fëmijëve;*
   - *Aktivitete dhe argëtime.*

Nr.		*Detyra*	*Ndarja e orëve të kontrollit*	*Norma javore*	*Javë*	*Totali i orëve të kontrollit*
1		Drejtori	Tematik dhe dokumentacion	6 - orë	35	210 - orë
2		Koordinatore	*Dokumentacioni dhe regjimi ditor*	4 - orë	35	140 - orë

NDARJA E DETYRAVE TË ANËTARËVE TË DREJTORISË

- ***Drejtor didaktik – Mynevere Terpo***

- *Ndan ngarkesën mësimore të mësuesve;*
- *Harton planet e drejtorisë në bashkëpunim me grupin e punës;*
- *Përgjigjet për ruajtjen e bazës materiale dhe të objektit;*
- *Cakton komisionin e inventarizimit të kopshtit;*
- *Jep vërtetime për të gjithë të interesuarit në raport me kopshtin;*
- *Kontrollon regjistrat e kopshtit;*
- *Ushtron ndihmë e kontroll në procesin mësimor në disa lëndë;*
- *Në procesin edukativ ndjek disiplinën e kopshtit.*

- ***Koordinatore – Aurelda Qama***

- *Përgjigjet për grupin e parë, të dytë dhe të tretë në drejtim të përparimit, frekuentimit, plotësimit dhe mirëmbajtjes së regjistrave, punën e mësuesve kujdestarë dhe lidhjen e tyre me prindërit e fëmijëve të klasave përkatëse;*
- *Përgjigjet për plan edukimin në kopsht, regjistrimet dhe shpërndarjen e fëmijëve në klasat përkatëse;*

- *Ruan kontingjentin e fëmijëve dhe rakordon me regjistrat e klasave;*
- *Harton orarin ditor dhe ndjek zbatimin e tij nga mësuesit;*
- *Ushtron ndihmë e kontroll në procesin mësimor në lëndë të ndryshme;*
- *Ndjek frekuentimin e fëmijëve në kopsht;*
- *Ndjek dhe organizon aktivitetet sportive dhe artistike.*

- ***Kryesekretarja :Kristina Kortoçi***
- *Kujdeset për ruajtjen e dokumentacionit të kopshtit;*
- *Mban kontakt me prindërit.*

BAZA MATERIALE E KOPSHTIT

- *Kopshti ka librin e inventarit.*
- *Drejtoria ngarkon një anëtar të drejtorisë për administrimin e bazës materiale, i cili mban kontakt me çdo mësues kujdestar.*
- *Drejtoria ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe administrative përgjegjësin teknik për çdo shkelje të vërejtur.*

LIDHJA ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN

- *Demokratizimi i këtyre lidhjeve do të jetë në qendër të vëmendjes.*
- *Do të dëgjohet mendimi i prindërve në mbarëvajtjen e punës në kopsht.*
- *Takimi me prindër: Çdo dy muaj.*

TEMATIKA E MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT TË MËSUESVE:

NR.	TEMATIKA E MBLEDHJEVE	PËRGJEGJËSI	AFATI
	1. Njohja me "Rregulloren për funksionimin e institucioneve parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimet e MA *2. Ndarja e klasave, mësuesve kujdestarë.*	*Drejtoria*	*31. 08.2026*

I	*3. Regjistrimet e fëmijëve.* *4. Baza materiale didaktike e fëmijëve dhe furnizimi.* *5. Gjendja e kopshtit dhe rregullimi.* *6. Planet mësimore.* *7. Njohja me draftin e planit vjetor të drejtorisë për vitin shkollor 2026 - 2027.*		
II	*Analiza mësimore me tematikë:* *"Arritje e detyrave në realizimin e objektivave të planit vjetor".*	*Drejtoria*	*Nëntor 2026*
III	*Takim analizues për rezultatet gjatë periudhës Shtator - Janar.*	*Drejtoria*	*Janar 2027*
IV	*Takim analizues për funksionimin e problemeve edukative. Realizimin e objektivave vjetore dhe zhvillimi i aktiviteteve.*	*Drejtoria* *Raporti nga mësuesit kujdestarë*	*Prill 2027*
V	*Analizë vjetore e punës së kopshtit*	*Drejtoria dhe stafi*	*Qershor 2027*

TEMATIKA E MBLEDHJEVE TË DREJTORISË

NR.	*TEMATIKA E MBLEDHJEVE*	*PËRGJEGJËSI*	*AFATI*
I	*Analizë e gjendjes së kopshtit për vitin shkollor 2026 - 2027.* *a- Njohja me "Rregulloren për funksionimin e institucioneve parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimet e MAS* *Masat që do të merren:* *b- Kuadri.* *c- Gjendja e kopshtit.* *d- Pajisja me bazë materiale.* *e- Sektori i shëndetësisë.* *f- Dezhurnet, regjistrimet.* *g- Risitë në mësimdhënie* *j- Miratimi i planit vjetor të kopshtit.*	*Drejtoria* *Drejtoria*	*30.08.2026* *28.08 - 07.09.2026*
II	*Gjendja e kopshtit pas fillimit të vitit të ri 2026 – 2027 e parë në planin e përgjithshëm të saj dhe e përqendruar veçanërisht në mbledhjet me mësuesit.* *a- Vështirësitë e fëmijëve në fushat e të nxënit.* *b- Mungesat pa arsye, kontingjenti.* *c- Baza mësimore e fëmijëve.* *d- Zbatimi i orarit mësimor.* *e- Rregulli e disiplina në përgjithësi.* *f- Lidhja me familjen.* *g- Ecuria e përdorimi të tabelave elektronike* *i- Implementimi i paketës "Mësoj duke luajtur"*	*Raportim i mësuesve kujdestarë* *Drejtoria*	*Fillimi i Tetorit* *Tetor 2026*

III	*1- Mbledhje e zgjeruar e drejtorisë së kopshtit me mësuesit.* *2- Analizë e mësimit me tabela elektronike* *3- Festa e Flamurit* *a-Masat për festim* *b-Përgatitja e skenarit* *c-Ndarja e aktiviteteve sipas grupeve*	*Raporti i mësuesve* *Drejtoria*	*Nëntor 2026*
IV	*1.Analizë e tremujorit të parë* *2.Viti i Ri - Masat për festim* *3.Puna e mësuesit*	*Drejtoria*	*Dhjetor 2026*
V	*Masat për mbylljen me sukses të 17 javëve të para të vitit.*	*Drejtoria*	*Janar 2027*
VI	*1- Analizë e punës së stafit drejtues.* *2- Mësuesit kujdestarë në veprimtaritë me fëmijët e prindërit.* *3- Higjiena e pastërtia në kopsht*	*Drejtoria* *Mësueset*	*Shkurt 2027*
VII	*1- Baza materiale e didaktike.* *Efektiviteti i përdorimit të aparaturave moderne.* *2- Zbatimi i rregullores së brendshme të kopshtit.* *3- Gjendja e mjedisit të kopshtit.* *4. 7-8 Marsi - Masat për festim*	*Drejtoria*	*Mars 2027*
VIII	*1- Realizimi i detyrave të stafit drejtues.* *2- Kualifikimi dhe përdorimi funksional i metodave në orë mësimi.*	*Drejtoria*	*Prill 2027*
IX	*1- Masat për realizimin me sukses të synimit të kopshtit, të dala nga analiza e gjendjes në kopsht.* *2- Mbi realizimin e objektivave të kopshtit deri në këtë periudhë*	*Drejtoria*	*Maj 2027*
X	*1- Analizë për mbylljen e gjithë vitit shkollor 2026 - 2027* *2- Mbyllja e vitit dhe plotësimi i dokumentacionit të kopshtit.* *3- Festa e 1-Qershorit dhe Festa e Lamtumirës*	*Drejtoria* *M. kujdestarë*	*Qershor 2027*

PLANI I PUNËS PËR KUALIFIKIMIN E MËSUESVE

a) Nisur nga synimi dhe objektivat që ka kopshti për vitin shkollor 2026-2027, shihet domosdoshmëria e përdorimit të mënyrave të mësimdhënies sa më frytdhënëse dhe bashkëkohore mbështetur në teknologjinë e fundit.

Planifikimi bazohet në punën individuale të çdo mësuesi dhe të grupeve që funksionojnë sipas grupmoshës së fëmijëve që mësueset kanë në kujdestari.

- *Aktivitete metodiko-shkencore;*
- *Trajnime të vazhdueshme për teknologjinë e fundit në mësimdhënie;*
- *Trajnime nga shërbimi psiko-social;*
- *Trajnime nga personalitete më në zë në fushën e mësimdhënies, brenda dhe jashtë vendit;*
- *Referohen tema nga mësues të ndryshëm çdo muaj;*
- *Realizohen mësime të hapura sipas profileve;*
- *Bëhen analiza dhe shkëmbim përvoje;*
- *Zbërthim i planeve mësimore bëhet sipas progameve.*

b) Anët e forta:

1. *Lidhja e qëndrueshme dhe e vazhdueshme e mësuesve me prindërit e fëmijëve për një mbarëvajtje në fushën e të nxënit dhe të edukimit;*
2. *Realizimi i veprimtarive me karakter shkencor dhe didaktik në çdo fushë në funksion të ngritjes profesionale të mësuesve;*
3. *Numri i madh i krediteve të fituara nga mësueset për një vit shkollor;*
4. *Trajnimet e shumta që organizohen ne ambientet e kopshtit.*

c) Anët e dobëta:

1. *Mos marrja pjesë në mënyrë të vazhdueshme në rrjetet profesionale.*
2. *Pamundësia e pjesëmarrjes fizike nëpër trajnime ndërkombëtare.*

INFRASTRUKTURA E KOPSHTIT

- Institucioni arsimor, kopshti jopublik "Turgut Ozal" Durrës është pjesë e kompleksit arsimor "Turgut Ozal", i cili u vu në funksionim të plotë në muajin Janar të vitit 2002 .
- Kopshti jopublik ''Turgut Ozal'' Durrës u hap me ''Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr .174, datës 16.06.2005 ''
- Ambientet e kopshtit kanë kapacitetet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat si në lidhje me mësimet ashtu dhe me ambientet argëtuese.
- E tërë infrastuktura është e organizuar ne harmoni të plotë me mënyrën e organizimit të gjithë procesit ditor për një mbarëvajtje sa më te mirë. Në përbërje të kopshtit janë 5 grupe të pajisura me sendet e nevojshme të qëndrimit dhe të procesit mësimor . Klasat e janë të pajisura me tabela elektronike për një mësim sa më frytëdhënes. Në kopsht janë të vendosura dhe lodrat duke krijuar një ambient argëtues dhe të sigurt.
- Pjesë e kopshtit janë edhe ambiente të tjera argëtuese dhe edukuese dhe salla e aktiviteteve të cilat u japin fëmijëve mundësi të mësojnë në mënyrë audiovizive.
- Gjithashtu lodra zbavitëse kemi edhe në ambientin e jashtëm. Krahas këtyre ne funksion të kopshtit eshtë edhe kinemaja apo salla e shfaqjeve.
- Të nje standarti bashkëkohor janë edhe metodat që ndiqen për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
- Mjetet mësimore në kopshtin tonë janë në gjendje shumë të mirë.
- Fëmijët janë të pajisur me tekste dhe mjete mësimore;

Anët e forta:

1. *Gjendja fizike shumë e mirë e godinës.*
2. *Televizorë Smart që funksionojnë normalisht sipas planit mësimor përkatës.*
3. *Ambiente sportive që funksionojnë në mënyrë të rregullt për realizimin me sukses të orëve mësimore.*

Anët e dobëta:

1. *Nevoja për përmirësimin dhe pasurimin e vazhdueshëm të mjediseve edukative dhe hapësirave të jashtme me materiale dhe elemente bashkëkohore, që nxisin lojën, kreativitetin dhe të nxënit përmes përvojës.*
2. *Bibliotekë e krijuar enkas për fëmijët e kopshtit .*

FAMILJA

Anët e forta:

1. *Pjesa më e madhe e familjeve u përgjigjen të gjitha nevojave të fëmijëve dhe merrem me formimin social-emocional të tyre.*
2. *Shumica e familjeve të fëmijëve të kopshtit tonë ka një lidhje të qëndrueshme dhe raporte shumë të mira bashkëpunimi me kopshtin.*

Anët e dobëta:

1. *Neglizhenca e disa prindërve në takimet me mësuesit.*

KOMUNITETI

Marrëdhëniet me komunitetin që na rrethon kanë qenë mjaft të mira.

Anët e forta:

1. *Prindërit kanë mundësi të vijnë dhe të interesohen për ecurinë e fëmijëve në çdo kohë. Kopshti ka ambiente të përshtatshme për pritjen e tyre.*
2. *Shërbimi psiko-social ndihmon në forcimin e marrëdhënieve me prindërit dhe komunitetin.*
3. *Pjesëmarrja e gjerë e prindërve gjatë aktiviteteve mësimore dhe ekstrakurrikulare.*
4. *Bashkëpunim shumë i mirë me institucionet e komunitetit pranë kopshtit.*

Anët e dobëta:

1. *Duhet një koordinim më i madh me komunitetin e në drejtim të aktiviteteve jashtë ambienteve të kopshtit.*

QËNDRIMI I KLIENTIT

Nga përfundimet e pyetësorëve të shpërndarë në fund të vitit mësimor të sapo kaluar në lidhje me faktin se sa të kënaqur janë fëmijët dhe prindërit nga shërbimi që ofron kopshti ynë rezultoi se:

1. *Kopshti ynë i përgjigjet kërkesave të komunitetit për një punë cilësore në mësimdhënie dhe edukim;*
2. *Mësuesit kanë një lidhje të qëndrueshme me prindërit e fëmijëve dhe koordinojnë shumë mirë punën me mësuesit e lëndëve të ndryshme.*

IV. SYNIMI

I: Modernizimi i infrastrukturës së kopshtit në funksion të mirëqenies së fëmijëve dhe procesit mësimor.

II: Krijimi dhe funksionalizimi i bibliotekës së kopshtit

V. OBJEKTIVAT

Për realizimin e këtyre synimeve objektivat e kopshtit do të jenë:

1. **Modernizimi i infrastrukturës së kopshtit në funksion të mirëqenies së fëmijëve dhe procesit mësimor.**

-Përdorimi i smartboard të paktën 3 herë në javë në grupin e 1 dhe të 2 për aktivitete gjuhësore, matematikore dhe njohuri për botën.

2. **Krijimi dhe funksionalizimi i bibliotekës së kopshtit**

- *Krijimi i një hapësire të përshtatshme dhe tërheqëse për lexim, të përshtatur me moshën dhe nevojat e fëmijëve 3–6 vjeç.*
- *Pasurimi i bibliotekës me libra dhe materiale didaktike, të përshtatshme për zhvillimin gjuhësor, emocional, social dhe krijues të fëmijëve.*
- *Nxitja e interesit dhe dashurisë për librin dhe leximin përmes aktiviteteve të përditshme dhe të organizuara.*
- *Përfshirja e prindërve në pasurimin dhe funksionalizimin e bibliotekës, duke krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm kopsht–familje.*

VI. PËR REALIZIMIN E KËTYRE OBJEKTIVAVE PARASHIKOHEN TË KRYHEN VEPRIMTARITË E MËPOSHTME:

NR	*PUNA QË DO TË KRYHET*	*PËRGJEGJËSI*	*AFATI*
I	***1. Veprimtaritë për arritjen e objektivave*** ● *Verifikimi ditor i frekuentimit të fëmijëve.* ● *Kontakte të menjëhershme me prindërit.* ● *Raportim ditor mbi shëndetin e fëmijëve* ● *Mbledhje e këshillit pedagogjik me shërbimin psikosocial në lidhje me mbarëvajten e fëmijëve në kopsht.*	*M. kujdestar* *M. kujdestar* *Mjeku* *Drejtori*	*Çdo ditë* *Vazhdimisht* *Çdo muaj* *Çdo muaj*
II	● *Pajisja me aparatura moderne (smarboard)* ● *Trajnimi i mësuesve për përdorimin e smartboardit dhe smart table.* ● *Organizimi i orëve model me pjesemarjen e gruit parashkollor.* ● *Krijimi i një këndi komod dhe tërheqës leximi, me jastëkë, rafte të përshtatshme dhe materiale vizuale.*	*Drejtoria e kopshtit* *Mësueset*	*Shtator - Tetor 2026* *Shtator - Tetor 2026* *Gjatë vitit*
III	● *Organizimi i një fushate "Një fëmijë – një libër" për dhurimin e librave* ● *Vizitë në qendrat e punës* ● *Organizimi i aktivitetit "Një ditë me prindërit"* ● *Organizimi i aktivitetit "Në ditë në kopsht"* ● *Krijimi i "Ditës së librit" dhe aktiviteteve me rastin e Ditës Botërore të Librit.*	*M. kujdestarë & prindërit* *Shërbimi Psiko-social* *M. kujdestarë & prindërit* *M. kujdestarë & prindërit*	*Tetor 2026* *Gjatë vitit* *Gjatë vitit* *Gjatë vitit* *Gjatë vitit*
IV	● *Ndjekja ditore e ecurisë së fëmijëve për shfrytëzimin e orëve të mësimit.* ● *Përgatitjë e fëmijëve që do të përfaqësojnë kopshtin nëpër olimpiadat e parashkollorit.* ● *Analizë e evidencave mujore për ecurinë e fëmijëve.*	*M. kujdestarë & prindërit* *Koordinatoret*	*Çdo ditë* *Gjatë vitit* *Çdo muaj*

FUNKSIONIMI -PROGRAMET -TEKSTET MËSIMORE

Në kopshtin tonë veprimtaria mësimore dhe ajo edukative, kriteret për rekrutimin e personelit mësimor dhe stafit drejtues, ngarkesat mësimore si javore, vlerësimi i fëmijëve si dhe përzgjedhja e teksteve mbështeten në Ligjin për arsimin parauniversitar si dhe në të gjitha dokumentet dhe udhëzuesit që dalin nga MA, ASCAP dhe ZVA Durrës

Tekstet mësimore janë të zgjedhura sipas grupmoshave të caktuara. Çdo fëmijë punon me setin e tij të librave.

VII. AKTIVITETET NË KOPSHT

Në themel do të jetë veprimtaria praktike për realizimin e synimeve të kopshtit për edukimin e fëmijëve si qytetarë të mirë të një shoqërie demokratike. Veprimtaria do të përqendrohet në karakterin praktik, argëtues e çlodhës. Drejtimet kryesore do të jenë ato të edukimit patriotik, moral, estetik, shëndetësor, mjedisor dhe me dimensione evropiane.

NR.	***AKTIVITETE NË SHËRBIM TË EDUKIMIT***	***PËRGJEGJËSI***	***AFATI***
I	• *Kolazh me këngë për fëmijë dhe veprimtari artistike për fillimin e vitit të ri shkollor 2026-2027.* • *Njohja me figurën dhe kontributin e Nënë Terezës.*	*Drejtoria* *Mësueset*	*Shtator 2026*

II	● *Mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë. Ushqehemi shëndetshëm. Festa e frutave.* ● *Sa më pëlqen cirku.* ● *Zhvillimi i "Javës Shqiptare" me aktiviktete të ndryshme si dramatizim,recitimi,këngë e valle.*	*Drejtoria* *Mësueset* *Drejtoria*	*Tetor 2026* *Nëntor 2026* *Shtator - Nëntor 2026*
III	● *Zhvillimi i një koncerti festiv për Festat e Nëntorit.* ● *Ekspozitë me temë: 'I dua simbolet e mia kombëtare'* ● *Njohja e stafit pedagogjik me materialet e UNICEF-it dhe Save the Children.*	*Drejtoria* *Mësueset* *Shërbimi psiko-social*	*Nëntor 2026*
IV	● *Edukimi për paqe dhe edukimi për zgjidhjen e konflikteve.* ● *Festimi i Vitit të Ri 2027.*	*Mësueset/Psikologu* *Drejtoria*	*Dhjetor 2026* *Dhjetor 2026*
V	● *Temë: "Adoptimi dhe realizimi i një kodi sjelljeje për të gjithë stafin dhe fëmijët e kopshtit që t'i kundërvihet të gjitha formave të dhunës dhe të sjelljeve që mbartin diskriminim".* ● *Analizë dhe reflektim mbi shfaqjet dhe format e dhunës te fëmijët*	*Mësueset/ Psikologu* *Këshilli i mësuesve*	*Janar 2027* *Janar 2027*
VI	● *Ekspozitë fotografike: "Higjiena dhe shëndeti".* ● *Tryezë e rrumbullakët: Të gjithë bashkë të parandalojmë dhunën në kopsht gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij duke evidentuar raste të sjelljeve të papërshtashme".*	*Drejtoria* *Psikologu* *Këshilli mësuesve* *Komuniteti prindërve*	*Shkurt 2027* *Shkurt 2027*
VII	● *7 dhe 8 Marsi - Montazh muziko-letrar*	*Mësueset*	*Mars 2027*
VII I	● *Seminar me prindër me temë: "Marrëdhëniet që gjenerojnë dhunë janë të dëmshme"* ● *Ekspozitë me temë "Unë ricikloj"*	*Psikologu* *Këshilli mësuesve* *Komuniteti prindërve*	*Prill 2027*

IX	• *Dita sportive e kopshtit* • *Vizitë në teatër* • *Olimpiada shkencore e parashkollorit*	*Drejtoria* *Mësueset* *Drejtoria*	*Maj 2027*
X	• *Manifestim fiskulturor dhe artistik për mbylljen e vitit 2026–2027.* • *Festa e fëmijëve* • *Festa "Lamtumirë kopsht"*	*Drejtoria* *Mësueset* *Drejtoria*	*Qershor 2027*

KONTRIBUTET

Kontributet e prindërve

Pjesëmarrja aktive në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve festive, artistike dhe kulturore.

2. Kontributet e komunitetit dhe partnerëve

-Bashkëpunim me qendra kulturore, artistike, sportive për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.

-Projekte të përbashkëta me qendra komunitare mbi edukimin mjedisor, artin dhe kulturën.

3. Kontributet e vetë institucionit

-Investime për modernizimin e infrastrukturës (ambiente të brendshme dhe oborre lojërash).
Pajisje me mjete didaktike bashkëkohore, lodra edukative dhe teknologji mësimore.

-Organizimi i trajnimeve për stafin edukativ.

IX. GRUPI I PUNËS

HARUN BOSTAN	ADMINISTRATOR
MYNEVERE TERPO	DREJTOR DIDAKTIK
KRISTINA KORTOÇI	PËRGJEGJËSE ZYRE
ALMA HARIZI SAKJA	PRIND
FATLINDA VESHI	MËSUES

Miratoi

Kryetari i bordit të prindërve
Alma Harizi Sakja

Drejtor Didaktik
Mynevere Terpo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TURGUT OZAL